

Revolucionalizimi i Edukimit nëpërmjet Open Educational Resources

Loina Prifti

Abstrakt

Open Educational Resources (OER) kanë fituar shumë vëmendje dhe popullaritet në vitet e fundit. Influenca e Web-it nga njëra anë dhe mendësia e shpërndarjes së dijes dhe pasurisë intelektuale nga ana tjetër, kanë krijuar një filozofi të re, filozofinë për ta bërë dijen të hapur për të gjithë. OER janë materiale të tipit: kurse, libra, leksione, artikuj etj, instrumente të ndryshme si laboratorë virtualë, simulacione dhe lojra si dhe software që mbështesin proceset mësimore dhe edukative. OER janë falas në web dhe mund të përdoren në version origjinal ose të modifikuar. OER gjithashtu ndihmojnë në shpërndarjen e njohurive në mbarë botën. Megjithatë për të përfituar prej OER është e rëndësishme të kuptohet roli i tyre në ndryshimin e mënyrave të edukimit. Ky artikull analizon historinë e OER si dhe çfarë ato ofrojnë dhe sfidat që paraqiten prej përdorimit të tyre.